



KËSHILLI DREJTUES

**VENDIM QARKULLUES**

**Nr. 26, datë 30.09.2020**

**Mbi miratimin e Strategjisë të zhvillimit dhe të menaxhimit të burimeve  
njerëzore në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronjat “dh” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të Prioritetit Strategjik II – Menaxhimi i kapitalit njerëzor të Planit Strategjik të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitet 2018 – 2020, të miratuar me Vendimin nr. 14, datë 31.05.2018 të Këshillit Drejtues, të nenit 7, pika 6, të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Strategjinë e zhvillimit dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**